



## Përmbledhje

“RIKON”, shpallë konkurs për:

### **Udhëheqës i Departamentit të Financave**

#### **Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

1. Përgatit pasqyrat dhe raportet financiare në periudha mujore dhe periodike për menaxhmentin;
2. Përpilon, menaxhon dhe monitoron zbatimin e politikës dhe procedurave të Departamentit të Financave;
3. Organizon, drejton dhe mbikëqyr funksionet, raportimit financiar, kontrollit dhe tatimeve si dhe përkujdeset për lehtësimin e operacioneve ditore;
4. Ndërton sisteme financiare dhe mekanizma të kontrollit të brendshëm që mbështesin drejtimin strategjik të kompanisë dhe parandalojnë rrezikun financiar;
5. Monitoron rrjedhën e parasë, llogaritë, transaksionet dhe parametrat tjerë financiar që tregojnë performancën financiare të kompanisë;
6. Ndhmon në parashikimin dhe mbikëqyrjen e investimeve kapitale, si dhe shqyrton praktikën për të rritur të hyrat dhe ulur kostot;
7. Identifikon, analizon dhe monitoron parametrat e risqeve financiare për të ndihmuar drejtuesit e lartë në krijimin e planeve strategjike;
8. Raporton rezultatet financiare për palët e brendshme dhe të jashtme dhe ndihmon departamentet përmes analizave financiare, informacionit menaxherial dhe rekomandimeve;
9. Përgatit, kontrollon dhe mbikëqyr rrjedhën e proceseve të përgatitjes së raporteve dhe pasqyrave financiare periodike dhe vjetore;
10. Mbikëqyr dhe menaxhon procesin e planifikimit të buxhetit dhe parashikimeve financiare në koordinim me departamentet tjera dhe përcjellë realizimin e tij në vazhdimësi;
11. Përkujdeset se të gjitha praktikën financiare janë në pajtueshmëri me legjislacionin dhe rregullat në fuqi;
12. Menaxhon dhe mbikëqyr procesin e regjistrimit dhe ruajtjes së të dhënave në pajtueshmëri me rregullat e brendshme;
13. Mban marrëdhënie profesionale me institucionet financiare, kontraktorët dhe palët tjera të jashtme;
14. Mban kontakte të vazhdueshme me furnitorët e jashtëm;
15. Mbikëqyr, koordinon dhe këshillon personelin brenda Departamentit të Financave;

### **Kualifikimet e kërkuara:**

1. Diplomë universitare në Ekonomi, preferohet kualifikimi pasuniversitar.
2. Kualifikim profesional në Kontabilitet (SCAAK, ACCA apo ndonjë shoqatë tjetër) e dëshirueshme;
3. Të ketë përvojë pune në fushën e menaxhimit të financave;
4. Aftësi udhëheqëse dhe të delegimit të përgjegjësive;
5. Kreativitet dhe iniciativë për ide të reja dhe përmirësime të proceseve të punës;
6. Aftësi për formulimin e strategjive financiare, raporteve financiare, politikave të kontabilitetit dhe procedurave të kontrollit të brendshëm në pajtueshmëri me objektivat e kompanisë dhe konform legjislacionit në fuqi;
7. Shkathtësi të shkëlqyera numerike dhe analitike;
8. Aftësi të shkëlqyera komunikimi në gjuhën angleze;

Të interesuarit t'i dërgojnë CV-të në e-mail: [smakolli@rikon-ks.com](mailto:smakolli@rikon-ks.com)